

VENDIM
Nr. 306, datë 23.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 795, DATË 26.11.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË VLERËSIMIT TË
OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, NË PRONËSI PRIVATE, TË
LUAJTSHME DHE KRITERET SHKENCORE E PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË
KËTYRE OBJEKTEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 9, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 795, datë 26.11.2003, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun I, “KOMISIONI I PËRHERSHËM I VLERËSIMIT”, shkronja “A” riformulohet, si më poshtë vijon:

“A. PËRBËRJA

1. Komisioni i Përherëshëm i Vlerësimit kryesohet nga drejtori i Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë, si më poshtë vijon:

- a) një ekspert etnolog nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit;
- b) një ekspert arkeolog nga Instituti i Arkeologjisë;
- c) një studiues i artit mesjetar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës;
- ç) një studiues i artit pamor nga Galeria Kombëtare e Arteve;
- d) një studiues i arkitekturës nga Instituti i Monumenteve të Kulturës;
- dh) një ekspert i fushës nga Universiteti i Tiranës, Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore;

e) një ekspert i artit pamor nga Universiteti i Arteve;

ë) një ekspert i jashtëm, sipas rasteve specifike të vlerësimit të objekteve.

2. Pranë këtij komisioni funksionon sekretaria teknike, e cila përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe një specialist i Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Sekretaria teknike nuk ka të drejtë vote, por ndihmon komisionin në mbarëvajtjen e mbledhjeve.”

2. Në paragrafin e tretë, të pikës 1, të shkronjës “c”, emërtimi “Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, zëvendësohet me “Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore”.

3. Në pikën 1, të kreut III, emërtimi “Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, zëvendësohet me “Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore”.

4. Shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të kreut III, riformulohen në një pikë të vetme, si më poshtë vijon:

“c) Për personat fizikë/juridikë, dokumentacionin e plotë ligjor të regjistrimit si person juridik në gjykatë, organet tatimore dhe organe të tjera të specializuara, vërtetimet nga gjykata, prokuroria dhe përmbarimi që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre, si dhe nuk është në proces gjyqësor, civil apo penal;”.

5. Pas pikës 1, të kreut III, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Dokumentacioni i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, letërnjoftimi, të dhënat e sakta të vendbanimit aktual dhe secili nga dokumentet e cituara në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të këtij kreu, në rast sigurimi përmes aksesit nga institucionet që i lëshojnë, do të sigurohen rast pas rasti nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.”.

6. Shkronja “a”, e pikës 8, të kreut III, riformulohet si më poshtë vijon:

“a) Për aktvlerësimin e objekteve:

- 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo objekt.”.

7. Kudo në tekst, emërtimi “Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, zëvendësohet me “Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore”, si dhe emërtimi “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohet me “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore”.

8. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama